


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	25/02/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Fehmi ZENA u.d. Drejtor i Prokurimit në SKGJK
CC:	z. Albert AVDIU Drejtor në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin “Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të IT-së për SKGJK-ën dhe Gjykatat e të gjitha regjioneve të Kosovës së bashku me degë”



I nderuar

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin “Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të IT-së për SKGJK-ën dhe Gjykatat e të gjitha regjioneve të Kosovës së bashku me degë”, me nr. të prokurimit: 33300-14-003-221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të IT-së për SKGJK-ën dhe Gjykatat e të gjitha regjioneve të Kosovës së bashku me

degë”, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Shërbimet e servisimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të IT-së për SKGJK-ën dhe Gjykatat e të gjitha regjioneve të Kosovës së bashku me degë”, me nr. të prokurimit: 33300-14-003-221. Ky aktivitet prokurimi më datë 28/01/2014 është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit të kësaj procedure të prokurimit nga “Dosja e Tenderit”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Seksioni II të FDT pika 30.1 Kriteret e dhënies, autoriteti kontraktues ka kërkuar: Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm - Kriteret për përzgjedhje: Çmimi ekonomikisht më i favorshëm ndarja e pikëve. 1) 60% çmimi tabela I; 2) 30% çmimi tabela II; 3) 10% çmimi tabela III. Nën-kriteret për tenderin Ekonomikisht më të favorshëm nuk mund të jenë të njëjtë, në secilin prej nën kriterëve kërkohet çmimi si kriter, atëherë cila është logjika e procedurës Çmimi Ekonomikisht më i Favorshëm.

Gjatë komunikimit zyrtar, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në mirëkuptim të plotë me Autoritetin Kontraktues dhe i njëjti autoritet është pajtuar që do ti merr të gjitha masat drejtë evitimit të parregullsive të paraqitura në këtë aktivitet. Më pas, Autoriteti Kontraktues ka anuluar aktivitetin e prokurimit dhe është zotuar se do ti merr gjitha hapat e nevojshëm gjatë ri tenderimit të aktivitetit të njëjtë.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit; Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës si dhe Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042.

Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë aktivitetit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për shërbyesit ose shërbyesit potencial.

Me respekt!